



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

Datë: 19/09/2023

Ref: 344/2023

RAPORT

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :

Subvencionimin e projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje publike me dt. 17.08.2023, për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Objektiva Strategjike, të Strategjisë Kombëtare për Mbrotjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht Objektiven IV Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, respektivisht:

Objektivi specifik IV.1 Zbatimi i politikave që mundësojnë ri integrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës

Veprimi IV 2.9 Subvencionimi i projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Qëllimi

Agjencia për Barazi Gjinore përmes kësaj thirrje është në zbatim të drejtpërdrejtë të Strategjisë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2023 dhe planit të tij të veprimit respektivisht,

Objektiven IV Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, respektivisht:

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendimmarrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej (pesë) 5 Organizata Jo Qeveritare të cilat para vlerësimit të projekteve të tyre komisioni ka bërë kontrollin administrativ të secilit aplikacion

Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike

1. OJQ Lady – Duke forcuar veten, ndryshohet jeta jote
2. Youth Partner – Gatime për bashkim : Libri i kuzhines
3. OJQ Mundësia – Fuqizimi ekonomik i grave, investim në mirëqenien e shoqërisë
4. OJQ Zana – Ri integrimi i mbijetuarave të dhunës në familje ndërmjet fuqizimit ekonomik
5. Këshilli rinor i Rahovecit – Fuqizimi ekonomik i gruas viktime e dhunës

Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr. të vendimit 326/2023 përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm, kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.


Komisioni Vlerësues sipas thirrjes publike të shpallur nga ABGJ dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas kriterëve të thirrjes publike, dhe kriterëve a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike të cilat ishin baza për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores MF-Nr.04/2017, nuk kalojnë në fazën e vlerësimit përmbajtësor dhe si të tilla diskualifikohen.

Bazuar në vlerësimin e lartshënuar Komisioni ka vlerësuar se nuk ka bazë për mbështetje financiare dhe rekomandon që ABGJ-ja të bëjë ri shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve.


Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Komisionin për ankese për subvencione në ABGJ në afatin prej 5 (pesë) dite nga data e publikimit. Ankesat duhet të dërgohen në kopje fizike në zyrat e Agjencisë për Barazi Gjinore, kati VII Ndërtesa e Qeverisë, sheshi Skënderbe.

Anëtarët e Komisioni

Shpresa Zariqi - Kryesuese



Jehona Xani -Anëtare



Yllka Kotorri-Anëtare



Arianit Jashari-Anëtar



Merita Shala -Anëtare

